



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	2-180/8050
Nr. i faq.	9
Date	01/09/2023

REFERENC-Ë:	Numër: 06-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	30.06.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 30.06.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjesë të 14 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leunora Shehu-DA, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj.Gentiana Tofaj-DZHE, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. **Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK(Mungon)**
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,
5. Raportimi i Kryesueses së Komisionit zgjedhor rreth zgjedhjeve të këshillave lokale në Komunën e Junikut,
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kemi një kërkesë nga drejtoria për Buxhet dhe Financa që si pike e rendit të ditës të jetë Rishqyrtimi dhe Miratimi i Rregullores së Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale për vitin 2023 sipas Rekomandimeve të Ministrisë, kush është për që kjo pikë të hynë si pikë e gjashtë e rendit të ditës? për 9 vota, kundër 2 vota dhe 3 vota abstenim, konstatoi se kërkesa e Drejtorisë e për buxhet dhe Financa u miratua. Tani e qes në votim rendin e ditës si në vijim:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunë e Junikut,
5. Raportimi i Kryesueses së Komisionit zgjedhor rreth zgjedhjeve të këshillave lokale në Komunën e Junikut,
6. Rishqyrtimi dhe Miratimi i Rregullores së Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale për vitin 2023 sipas Rekomandimeve të Ministrisë,
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

E hapi debatin për rend të ditës.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, qitja në votim një kërkesë për të futur në rend të ditës një pikë që nuk ka material, për mua është e çoroditur, material jo, dhe hajde ta votojmë, dhe kjo nuk është në rregull.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për të gjithë, kjo rregullore ju ka nënshtruar një rishikimi nga ana e ministrive të linjës, ka një koment të shkurtër për një plotësim të vogël të disa taksave, për ndryshe rregullorja është miratuar me të gjitha votat e këtij kuvendi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër rreth rendit të ditës nuk ka, e qes ne votim rendin e ditës me piken e shtuar, kush është për, për 11 vota, kundër 2 vota kundër, dhe 1 votë abstenim, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje

z.Shpejtim Gacaferi, përpos znj.Ermelinda Lllolluni (LDK), na ka njoftuar se do të mungoj për këtë mbledhje të gjithë tjerët anëtar të kuvendit të Komunës së Junikut janë prezent në sallën e Kuvendit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes së Maj-2023, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 1 votë, konstatoi se procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e projekt Kornizës afatmesme buxhetore e bëri znj.Vjollca Qestaj, Drejtoresh be DBF, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoj para anëtarëve të Kuvendit Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kornizës afatmesme buxhetore, në si grup i LDK-se e përkrahim sepse shohim se ka rritje të konsiderueshme të projekteve, por unë desha që të pyes për tri projekte të viti 2023, ndërtimi i kanalit të ujitjes, "Topillë-Gaxherr", me herët në këtë projekt ka qenë i përfshirë edhe kanali të "lapidari Qok", ndërsa tani po e shohë se nuk është i përfshirë në këtë projekt kanali të lapidari qok por vetëm "Topille-Gaxherr", çështja tjetër ka të bëjë me ndërtimin e kanalizimeve sekundare, a mundem me e ditë se për ku janë ndarë këto 50000€, si dhe kanalizimi i ujërave të zeza lokacioni "Miroc" dhe lagjen "Krasniq", dua të di me saktë se për ku bëhet fjalë.

z.Zenun Shala, përshëndetje për të gjithë, projekti i urave të zeza që janë ndare 50000€ ka të bëjë me këto lokacione: "Laxhen Gaxherr i epërm". lagjen "Bajraktar", lagjen Krasniq", dhe në lagjen "Miroc", ndërsa sa i përket kanalizimeve të ujitjes në projektin Topillë-Gaxherr është i përfshirë edhe kanali që është të lapidar në Qok.

z.Leonard Lllolluni përshëndetje për të gjithë. Projektet që janë prezentuar në tabelën e KAB-it janë projekte të përsëritura, janë projekte që janë të shkruara që pesë vite, bile disa nga to i kam shkruar edhe vet, u përmend se janë mbajtur disa dëgjime publike, dhe në kemi parë se në ato dëgjime publike kanë marrë pjesë vetëm zyrtarët komunal, nuk ka patur prezencë të qytetarëve, dhe ato propozimet që kanë dalë nga ato dëgjime publike nuk e di se nga kush janë bërë, vetëm nëse janë bërë nga zyrtarët komunal, dhe po më intereson se për cilat vite i keni futur për realizim këto projekte.

znj.Vjollca Qestaj, për vitet 2024-2026.

z.Leonard Lllolluni, kam edhe një çështje që është ndërtimi i zyrës informatike turistike, dhe ishte e cekur se planifikoni ta ndërtoni në vitin 2024-2025, kaq kohë ju duhet që ta ndërtoni një zyre, dhe me sa kame informacion komuna ka fituar një donacion nga italianet për ndërtimin e një zyre informuese turistike për këtë vit, a ketu e keni paraqitur për dy vite.

znj.Gentiana Tofaj, përshëndetje për të gjithë, është e vërtetë që ne si Komune e kemi fituar një projekt nga naturo Kosova, për ndërtimin e zyrës informuese turistike, dhe për momentin jemi vetëm në fazën fillestare në përgatitjen e dokumenteve dhe nuk e dimë se a do të përfundojë në tansi në vitin 2024 kështu që e kemi parapare që edhe në vitin 2025 të vazhdojë, por nuk do të thotë se kjo mbetet kështu, sepse nëse projekti përfundon para vitit 2025 në parashikimin e buxhetit për vitin 2025 e largojmë atë si projekt.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, u fol për kanalizimin e ujitjes së tokave bujqësore, dhe unë desha të pyes drejtorin, se pse nuk keni paraparë ndërtimin e këtyre kanaleve të ujitjes edhe në lokacionin “kallavaj” në pjesën ku gjinden pronat e banoreve të lagjes “Gacafer” nga shtëpia e “Brahim Haxhisë” e deri te ara e “Smajl aruqve” që i quajmë ne, është një pjesë shumë e madhe e pronave që bujqit tanë kanë nevojë për këto kanale të ujitjes behet fjalë për mbi 100 hektar toke bujqësore. Pse nuk po ndodhe ky ndërtim i këtyre kanaleve të ujitjes por po shkoni në mënyrë selektive jo të qoku jo të dobrosi.

z.Zenun Shala, ne kemi një projekt me ministrinë që ti ndërtojmë 4000m kanale të ujitjes dhe i kemi ndarë në neper lagje të Komunës së Junikut dhe unë besoj se “lagjeja Gacafer” nuk është e dëmtuar nga kjo.

z.Lulzim Gacaferi, në këtë çështje e kemi ngritur shumë here këtu në këtë kuvend, por kjo është edhe si premtim i yni ndaj qytetarëve në zgjedhjet e fundit, andaj unë si përfaqësues i popullit dhe njeri ndër me të votuarit si asamblist në zgjedhjet e fundit komunale kërkoj që ju para se të ndani projektet si këto ndërtimin e kanaleve të ujitjes të konsultohuni me neve, por ju as që nuk merrni mundin për këtë çështje dhe këto premtime po mbesin pa realizuar, në atë pjesë që e ceka janë me shumë se 100 hektarë tokë bujqësore dhe unë dua të di se kur do të ndërtoni kanalizimin për ujitje në atë pjesë.

z.Ruzhdi Shehu, në qysh në vitin 2022 është dashur të fillojnë punimet me grandin e qeverisë por vonesa ka ardhur si rezultat i ankesave dhe kjo i ka shtyrë fillimin e punë për afërsisht një vit, dhe kjo shtyrje ka ndikuar që të mos të ketë grand të dytë nga ministria, dhe pas përfundimit të grandit të parë të ministrisë do të ketë prap edhe një grand tjetër dhe besoj që të gjitha kanalet e ujitjes do të kryhen.

z.Zenel Maloku. Unë kam bërë kërkesë shumë here për fshatrat Jasiq-Gjocaj që në ato 4000m kanal të ujitjes që janë parapare të ndahen disa metra edhe për këto dy fshatra, kërkesa ime ka qene për një kanal të ujitjes në gjatësi 300m në fshatin “Gjocaj” e që me këtë kanal do të ujiteshin edhe tokat e fshatit Jasiq, dhe sipas të gjitha gjasave nuk do të ketë ndërtim të këtij kanali në atë pjesë, dhe kjo nuk është e mirë, çështja e dytë është për kërkesën e ndërtimit të rrugës në fshatin “Gjocaj” edhe kjo me sa pashe nuk është e paraparë në KAB, dhe nuk është

mirë që të këto fshatra të anashkalohen sepse këtu në Junik nuk ka shtëpi që nuk ka rrugë, e juve nuk ju ka shkuar asnjëherë mendja që të dilni në teren dhe të shikoni gjendjen se si është në këto fshatra. Unë i drejtona Kryetarit të Komunës me një kërkesë që ta ketë parasysh ndërtimin e rrugës në fshatin "Gjocaj" që ka qenë përpara dhe ta lidhe me rrugën që qonë në drejtim të bjeshkës, sepse rruga aktualisht është shume me shume se 25% përpjetë.

z.Ruzhdi Shehu, për qasjen në rrugë e këtyre banorëve, në kemi biseduar me ta që të na i lirojnë parcelat ka shkon rruga dhe në e kemi planifikuar, tani priten të behën matjet gjeodezike dhe të epët pëlqimi në menyre që të behet rrugë publike për banoret e atjeshëm.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, konstatoi se në sallën e kuvendit gjinden 13 anëtarët e kuvendit, e qes në votim, Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026 kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 2 vota, një anëtar nuk voton, konstatoi se me 10 vota për, miratohet projekt Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut, e beri z.Demokrat Ganiqaj, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e shqyrtoi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut.

z.Sadri Krasniqi, në si grup i LDK-se e përkrahim këtë rregullore.

z.Leonard Llojuni, unë edhe herën e fundit kur kemi folur për këtë rregullore kam qenë kundër sa i përket tarifës për konsumatorët shtëpiak pse të ngritët kjo tarifë nga 5€ sa është tani në 6€.

z.Ruzhdi Shehu, kjo është si pasojë e ngritjes së inflacionit në nivel vendit, në e dimë se të gjitha çmimet kanë pësuar ndryshime dhe kjo ngritje e lehtë e kësaj tarife nga 5€ në 6€ është pasojë këtyre ngritjeve si të derivateve, pagat e punëtorëve e deponive të mbeturinave që ndikojnë automatikisht në këtë ngritje.

z.Lulzim Gacaferi, unë dua të di se kush është kjo kompani që bënë grumbullimin e mbeturinave në komune tona,

z.Ruzhdi Shehu, operatori dehtë kompania regjionale publike ambienti me seli në Pejë, deri sa ta bëjmë kompaninë tona si komune.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, konstatoi se në sallë janë prezent 13 anëtarët e kuvendit, kush është për këtë Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komune e Junikut, për 11 vota, kundër 2 vota dhe 0 vota abstenim, konstatoi se me 11 vota për Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut, u miratua.

5. Raportimi i Kryesueses së Komisionit zgjedhor rrethe zgjedhjeve të këshillave lokale në Komunën e Junikut,

Shpjegimin dhe arsyetimin e Raportimi i Kryesueses së Komisionit zgjedhor rrethe zgjedhjeve të këshillave lokale në Komunën e Junikut, beri znj.Eliza Pepshi kryesuese e këtij komisioni, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë e me pas e shpjegoi dhe e arsyetoi Raportimi i Kryesueses së Komisionit zgjedhor rrethe zgjedhjeve të këshillave lokale në Komunën e Junikut, para anëtarëve të kuvendit.

z.Leonard Lolluni, sa i përket këtij raporti unë kam një çështje që lidhet me kërkesën që është drejtuar këtij komisioni, kërkesa është kinse e bere nga përfaqësuesit e fshatrave, ndërsa ne kërkesë nuk ka patur të bashkangjiture fare të kopjes së letërnjoftimit dhe nuk dihet se as kush e ka nënshkruar, me gjase e ka nënshkruar drejtori i shërbimeve, z.Demokrat Ganijaj, dhe kjo është e jashtëligjshme.

z.Zenel Maloku, z.Xheladin Jasiqi që është i cekur me emër se ka bere ankesë, thotë se as nuk ka qenë në komune, as nuk kam bere ankesë dhe as nuk kam dozuar ankesë, dhe unë po pyes se kush e ka dorëzuar ata ankesë, po ashtu pyetja shtrohet se nëse dikush parashtron ankesë a duhet ta ketë emrin të cekur dhe a duhet të ketë një kopje të letërnjoftimit.

znj.Leonora Shehu, një kërkesë të tillë e ka patur komisioni i ankesave dhe ka marr përgjigje, dhe për këtë çështje mund ta pyesni komisionin e ankesave.

znj.Eliza Pepshi, ne si komision kemi bere kërkesë që me ditur se kush ka bere këtë ankesë, dhe nga informatat që na i kane dhënë ka qenë emri i z.Xheladin Jasiqi.

Sqarim shtesë lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve për këshillat lokale fjalën e mori znj.Leonora Shehu, e cila ne vazhdim sqaroi dhe raportoi se si kanë vajtur zgjedhjet neper këshillat lokale.

6. Rishqyrtimi dhe Miratimi i Rregullores së Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale për vitin 2023 sipas Rekomandimeve të Ministrisë,

Shpjegimin dhe arsyetimin e kesaj rregullore e beri znj.Vjollca Qestaj, drejtoresh Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka para ase ta qes ne votim këtë rregullore konstatoi se ne sallë janë prezent, 12 anëtarët e kuvendit, e qes ne votim i Rregullore për Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale për vitin 2023 sipas Rekomandimeve të Ministrisë, kush është për? për 10 vota, kundër 1 votë, dhe abstenim 1 votë, me 10 vota për Rregullore për Taksave, Ngarkesave dhe Gjobave Komunale për vitin 2023 sipas Rekomandimeve të Ministrisë kalon.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për të gjithë, unë desha të pyes lidhur me objektin e ri të shkollës fillore “Edmond Hoxha”, a është pranuar apo a do të pranohet, pranimi teknik i objekti dhe nëse

është pranuar a dini te me tregoni se kur do te lëshohet për nxënës, sepse ne kemi qen këto ditëve te fundit ne atë objekt dhe vërejtëm se ka prishje bukur te mëdha.

z.Lulzim Gacaferi, meqë është prezent drejtoresha e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, desha te pyes lidhur me objektin e ndërtuar ne lokacioni e quajtur “Livadhi i Madh” dhe pyetja ime ka te beje se çka ka ndërmarrë komuna lidhur me zhvillimin e turizmin ne komunën tone ku dihet se ky aset ekonomik është tepër i rëndësishëm për komunën dhe qytetarët e komunës tonë, po ashtu dihet se kulla e ndërtuar ne “Moronicë” është e përgjysmuar për nga ndërtimi dhe po ashtu dua te di se kur do te jetë kjo Kullë ne funksion dhe ne shërbim te komunës tonë?

z.Zenel Maloku, unë i kame disa pyetje, po ashtu kam edhe një kërkesë qe ka te beje me festimin e çlirimit te Junikut ku ne e kemi festuar me datën 13.06 dhe kemi mbajtur mbledhje solemne ne kit salle, kjo date nuk është festuar vetëm këtë vit por është festuar qe shume vite, por sipas mendimit tim nuk është date e qëlluar për atë qe ne e festojmë, Komuna e Deçanit e feston si datë te çlirimit me 16.06, ndërsa me datën 13.06.1999 është vrarë ushtari i fundit ne betejën e Koshares nga forcat ushtarake Serbe, Juniku nuk ishte ne atë kohe komune dhe shtrohet pyetja se si u vendos kjo date e çlirimit te Junikut dhe unë kërkoj nga Kryetari i Komunës z.Ruzhdi Shehu qe ti shqyrtoj me arteret e kohës këtë çështje dhe te caktohet një datë reale e çlirimit te Junikut, sepse data 13.06 nuk është date reale dhe qytetarët janë te hamendur per këtë datë, çështja tjetër ka te beje me taxit, Kryetari i Komunës me parë na pat thënë se me nderimin e stacionit te autobusëve do ti largojmë taxistët nga qendra e Junikut dhe do ti vendosim ne stacionin e autobusëve, tjetër ka te beje me trotualet, këtë çështje e kam ngritur shume here sa qe po me duket se po bani hajgare me mua për këtë çështje, trotualet ne komunën tonë janë te nxëna nga automjetet dhe perderi sa janë te nxëna ka rrezikshmëri edhe për nxënësit por edhe për qytetarët dhe per këtë çështje unë i fajësoj katër veta, kryetari i komunës, komandantin e policisë stacioni i Junikut, drejtorin e shërbimeve publike dhe drejtorin e arsimit, çështja tjetër ka te bejë me rrugën te rampa e vjetër ne fshatin Jasiq është duke u dëmtuar çdo ditë si mendoni te ja beni, dhe çështja tjetër qe ka te beje me zyrën e informimit për turistë, po me intereson se ku do ta ndërtoni ne qendër apo diku tjetër dhe çfarë informimi do te beje kjo zyre?

z.Xhavit Velijaj, përshëndetje për te gjithë, sa i përket pranimit teknik te objektit te ri te shkollës fillore, kontrata ka qenë tri vjeçare dhe ka pasur te përfundojë ne muajin e 11 te vitit 2022, mirepor për shkak te pandemisë për shkak te kësaj ju kanë dhen afatet e reja qe me te munden te përfundojnë këtë vit, ne kemi planifikuar qe ne shtator te këtij viti te startojmë me mësim ne këtë objekt te ri, inventarizimin i objektit vetëm ka filluar, dhe siç e dini kompetencat për këtë objekt i ka ministria e arsimit sepse është kontratë e ministrisë, por edhe për kundër kësaj ne jemi duke i bere detyrat qe neve na takojnë dhe jemi duke kërkuar qe aty ku ka dëmtime ti sanojnë dhe te mos këtë asnjë dëmtim dhe qe mësimi ta fillojmë ne shtator.

znj.Gentiana Tofaj, përshëndetje per te gjithë, pyetja ke për shtëpinë e bjeshkatarëve dhe për objektin ne “Moronicë”, fillimisht po ndalem te objekti qe është ne Moronicë dhe sa i përket këtij objekti unë nuk kam kompetencë qe te flas për këtë objekt sepse është projekt i nisur nga administrata dhe akoma nuk ka përfunduar, dhe unë do pergjigjem vetëm për objektin qe gjendet ne livadhin e madh, ne ne fund te maujt prill i kemi derguar dokumenta per shpronsim te objekti dhe per dy hektar per rrethe keti objekti qe kjo prone te kaloj ne pronsi te komunes ne menyre qe ne ta japim ne shfrytezim per qytaret apo edhe per biznese e qe eshte ne dobi edhe te komunes,

por pa konfirmimin e kësaj kërkesë ne nuk kemi planifikuar asgjë. Ndërsa sa i përket turizmit, ne kuadër të projektit Natur "Kosova" ne tri komunat e perëndimit të Kosovës janë hapur grandet për fermer biznese individuale dhe për OJQ dhe e them për këtë që ta keni si informatë që të mundeni ta perhapni sa më shumë që të informohen sa më shumë qytetarët për biznese.

z.Lulzim Gacaferi, ju that se nuk është kompetencë e juaja ndërtimi i kullës në Moronicë, po ju jeni këtu në komune duhet ta keni atë informatë dhe të na pergjigjeni këtu në Kuvend.

znj.Gentiana Tofaj, unë thash që nuk është kompetencë e imja te flas, pasi që objekti në Moronicë është projekt i Administratës por perkundër kësaj unë do mundohem te marë informata lidhur me këtë dhe te jua sjelli këtu në Kuvend ne të ardhmen.

z.Shpajtim Gacaferi, çdo pyetje që shtrohet këtu në kuvend drejtorët kanë afat qe mbrenda dy jave te pergjigjen ne ate pyetje nese nuk kanë informata lidhur me pytjen.

z.Lulzim Gacaferi, ne rregull unë pres pra që brenda dy jave të mar pergjigje lidhur me objektin ne Moronicë.

z.Shpejtim Gacaferi, sa i përket pyetjes se z.Zenel Maloku, lidhur me daten 13.06 si datë e çlirimit te Junikut, edhe unë kam qenë kundër kësaj date mire por te tjeter kane vendosur per kete date dhe ne statutin e komunes se Junikut eshte kjo date, dhe siq dihet statuti i komunes kalon neper kuvend dhe nese eshte vullneti i ekzekutivit dhe i kuvendi ky statut ndryshon.

z.Ruzhdi Shehu, ne jemi duke e hartu disanimin e qendres dhe do ta shohim sisemimin e objekteve sipas eksperteve, ne mundemi me mare nje vendim ti qesim por kjo nuk eshte e mire, por besoj se edhe kjo kryeht dhe do te kemi sistemimin e çdo objekti ne qender, une pajtohem qe kemi ngarkese ketu ne qender e kjo ngarkese eshte problem edhe per policin edhe per nxensat qe e ceket me heret, prandaj dueht te kemi nje analize per qendren dhe duhet te kemi lirim te tortuareve dhe te kemi levizje te lire te nxensave te qytareve. Ndersa sa i perkete qeshtjes tjeter qe ngritet per rrugen nga laura e vjeter ne drejtim te fshatit Jasiq, me projekti qe kemi mirembajtja e rrugeve besoj se shume shpejt do ta kemi nje operatore ekonomik qe do te beje intervenimet në atë pjesë.

. z Leonard Lllolluni, une kame tri pyetje, e para, kam parë në medija qe një veturë zyrtare e keni harruar ne Fushë Kosovë, çka ka ndodhur me te si e keni harruar. E dyta, sa i përket disajnitimit te qendrës, unë e kam ndegjar z.Lulzim Gacaferi qe e kam projektin e gatshëm, pse me paguar komuna edhe një here. Dhe e treta, trotuaret me nje vendim te kryetarit munden me u liruar, por nuk e ka gatishmërinë dhe nuk i konvenon sepse edhe vet rrin ne ato kafeteritë.

z.Zenel Maloku, unë e kam një kërkesë, ju e dini se ne këtë muaj ka ndodhur nje rast me turistët e huaj ne bjeshkën e Junikut qe kanë humbur, dhe njerzit e Junikut te cilët i kanë gjetur dhe shpëtuar këta turistë të huaj, ky gjest i këtyre qytetarëve ja ka ngritur autoritetin Junikut, dhe ky gjest nuk ka te bejë me animet apo subjektet politike por është gjest human dhe ne kuadër te kësaj kërkoj qe këtyre personave, komuna te i nderon me nga një mirënjohje.

z.Lulzim Gacaferi, u fol për taksistë, kryetar lëshojte një vendim dhe largoj taksistët nga qendra, nuk është e hijshme që ata te qëndrojnë në qendër. Pata pyetje po ashtu rreth QKMF_se, e kemi

disukutuar shumë herë ketu ne kuvend se kur do të funksionoj QKMF_ja 24 orë dhe pyetja tjetër ka të bëjë me aparaturën e rëntgenit kur do të jetë funksionale dhe këtë pyetje do ta parashtroj deri sa kjo aparaturë e rëntgenit të jetë funksionale.


z.Fatos Shala, përshëndetje për të gjithë, herën e fundit të kam thënë se në gjashtmuorin e dytë të këtij viti do të pergaditet pjesa e kërkesës dhe e zotimit për stafin e mesëm të personelit, jemi ne proces të tenderimit. Ne kemi nevojë që ministria të na ndihmojë me shumë kur të filloj funksionimi 24 orë, sepse sipas ligjeve në fuqi frunizimi me barna esenciale është sipas numrit të banorëve dhe ne kemi kërkuar që furnizimi me barna esenciale të bëhet sipas numrit të shërbimeve sepse në QKMF mbi 50% e shërbimeve bëhet për qytetarët e komunave për rreth. Sa i përket rëntgenit ne kemi hapur konkurs për radiolog dhe nuk është paraqitur asnjë radiolog, konkursi ka qenë i hapur në nivel vendi, dhe për të qenë ne funksion ajo aparaturë e rëntgenit na duhet një radiolog, teknikut që e kemi pranuar me herët për të punuar me këtë aparaturë nuk e ka kualifikimin e radiologut, do të hapim prap konkurs për radiolog apo do të gjejmë ndonjë formë tjetër që këtë aparaturë ta funksionalizojmë.

znj.Leonora Shehu, sa i përket veturës në Fushë Kosovë, vetura ka qenë në shfrytëzim zyrtar, ka patur një defekt, personi zyrtar e ka raportuar defektin, në atë kohë nuk kemi patur kontratë për mbikqyrje të automjeteve dhe sa po është nënshkruar kontrata kemi bërë kërkesën dhe e kemi bartur për në autopark.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli të mbyllur mbledhjen e qershorit -2023

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

